

Reginald McNeil
Shefi Operativ

18 Mars ,2022

Të Nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Departamenti i Shëndetit Publik të Filadelfias (PDPH) vazhdon të tregojë se numri i rasteve me COVID-19 në Filadelfia ka mbetur vazhdimisht i ulët. Kjo rënie e rasteve pozitive ka rezultuar në zero mbyllje shkollash gjatë disa javëve të fundit, duke sinjalizuar një ndryshim të mirëpritur drejt një ndjenje normaliteti brenda komunitetit tonë të Drejtorisë Arsimore. Për shkak të këtij progresi pozitiv, **Divizioni i Shërbimeve Ushqimore do të mbyllë 12 vendet e mbetura të shpërndarjes së vakteve ushqimore pas ditës së sotme, e Premte, 18 Mars 2022.**

Nëse ndodh një rritje e rasteve pozitive me COVID dhe një shkollë e drejtorisë udhëzohet të mësojë studentët në mënyrë virtuale, Divizioni e Shërbimeve Ushqimore do të shpërndajë mëngjesin dhe drekën çdo ditë në shkollë, duke filluar nga ora 9:00-11:00 e ditës së nesërme Ushqimi do të shpërndahet çdo ditë derisa shkolla të rifillojë mësimin normal në - person. Çdo familje që vazhdon të kërkojë mbështetje ditore të vakteve ushqimore duhet të vizitojë www.phila.gov/food për të gjetur informacione rreth vendeve të ushqimit që operohen nga Qyteti i Filadelfias.

Ne jemi mirënjohës që kemi qenë në gjendje t'i ofrojmë këtë shërbim komunitetit të Filadelfias dhe do të vazhdojmë të bëjmë çmos për të mbështetur studentët tanë dhe për të përmbushur nevojat e tyre ushqimore.

Sinqerisht,

Drejtorja Arsimore e Filadelfias
Divizioni i Operacioneve